

Data: 18.09.2023

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “FV 2 (DY) ÇELËSA 3 POLAR 245 KV ME GAZ SF6 NË HEC FIERZË, 1 (NJË) ÇELËS 3 POLAR 245 KV ME GAZ SF6 PËR BLOKUN E AG2 HEC VAU DEJËS, SISTEM MONITORIMI TË PARAMETRAVE PËR 8 ÇELËSA NË TË DY HEC-ET, DHE ZËVENDËSIM I 4 PANELEVE NDËRMJETËSE KKL NË HEC FIERZË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 237,900,000 (Dyqind e tridhjetë e shtatëmilion e nëntëqindmijë) Lek, pa TVSH ose 2,236,112 (Dymilion e dyqind e tridhjetë e gjashtëmijë e njëqind e dymbëdhjetë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18/09/2023 është 106.39 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve të viteve: 2020, 2021, 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar me licencë profesionale të shoqërisë të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë

16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, për punime elektrike dhe mekanike në kategoritë:

-NP 11/A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve linjat e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

-NS 14/A Impiante te brendshme, elektrik, telef, radiotelefo Tv,

dhe të ketë drejtues teknik në licencë minimalisht 1(një) ing elektrik dhe minimalisht 1(një) ing. mekanik.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

✚ Licencën e shoqërisë

✚ Kontratë pune të vlefshme;

✚ Diplomën e inxhinierëve;

✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Qershor 2023- Gusht 2023.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 germa c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pikat e licencës së kërkuara në këtë kriter lidhen ngushtë me kërkesat sipas specifikimeve teknike ku kërkohet jo vetëm furnizimi i vendosja i çelsave, paneleve të monitorimit të tyre etj, si dhe do të kryhen demontimet e parashikuar në specifikimet teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të ketë në stafin e tij:

- Minimumi 1(një) Inxhinier Elektrik të çertifikuar nga prodhuesi/ institucione të autorizuar për për instalimin dhe komisionimin e pajisjeve monitoruese të Çelesave.
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektrik, të çertifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuar për mbrojtjet rele dhe komandimeve.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Kontratë pune të vlefshme;

- Certifikatat e mësipërme të vlefshme,
- Diploma
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Qershor 2023 – Gusht 2023

Shënim: AK do të lejojë që një Inxhinier të ketë më shumë se një certifikim. Gjithashtu, Inxhinierët e kërkuar mund të jenë pjesë e licencës së shoqërisë.

Argumentimi: Për sa i takon kriteret **2.3.2** dhe **2.3.3**, kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Instalimi i çelësave 245 kV në Nst është një sfidë e kërkuar në fushën e inxhinierisë, e cila kërkon një kompetencë të lartë teknike për të integruar me sukses çelësin në skemat ekzistuese elektrike dhe për të plotësuar të gjitha specifikat teknike që lidhen me pajisjet e tensionit të lartë. Përveç kësaj, për montimin e panelave ndërmjetëse KKL dhe instalimin e tyre, OE (Operatori Ekonomik) duhet të sigurojë se disponon kapacitetet njerëzore të nevojshme për të kuptuar dhe interpretuar me saktësi skemat elektrike sekondare dhe primare. OE duhet të kujdeset për komisionimin e çelësave dhe paneleve, si dhe për dokumentimin e tyre në formën e skemave "AS built". Në këtë kontekst, OE duhet të dëshmojë se disponon inxhinierë elektrikë të kualifikuar /çertifikuar në stafin e tyre.

Për montimin e çelësit në strukturat metalike dhe kolaudimin e tërë mekanizmave të kutisë së komandimit të çelësit, është e rëndësishme të angazhohen punonjës me një nivel të lartë kompetence në fushën e sistemeve mekanike. Në fakt, OE duhet të demonstrojë se ka të paktën një(1) inxhinier mekanik në stafin e tyre, të cilët do të jenë përgjegjës për realizimin e kësaj pune të ndërlikuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose distributor i autorizuar për pajisjet që do të ofrojnë.

-Çelesat 245 kV;

-Sistemin e monitorimit të çelësave

-Panelet e KKL

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit ose distributorit është një dokument i rëndësishëm në procesin e prokurimit publik. Ky dokument është thelbësor për disa arsye kryesore. Së pari, ai siguron origjinën e mallrave që janë të nevojshme në procedurën e prokurimit, duke na ofruar një dëshmi konkrete se ofertuesi është i autorizuar zyrtarisht për të ofruar këto mallra . Për më tepër, autorizimi tregon se ky ofertues ka kapacitetin teknik dhe mbështetjen e nevojshme për projektimin, prodhimin, instalimin dhe testimet e këtyre mallrave në vend.

Në të njëjtën kohë, kjo kërkesë për autorizim është lidhur ngushtë me cilësinë e mallrave që kërkojmë të blejmë, pasi tregon se këto mallra janë prodhuar në përputhje me standardet e duhura ose nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter nuk është një kriter diskriminues, por një mënyrë e qartë për të vlerësuar aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e ofertuesit për t'u përballur me projektin tonë.

Ky kriteri shërben për të siguruar që ofertuesi ka kapacitetin e nevojshëm dhe kredibilitetin për të përmbushur me sukses kontratën. Këtë kriter e gjejmë të përmendur në legjislacionin zbatues, ky kriter është në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe neni 40, pika 6 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, *për Çelesat 245 kV, Sistemin e monitorimit të çelesave, Panelet e KKL* të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në website të tyre përkatës.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Katalogët Teknikë janë të rëndësishëm sepse ata ndihmojnë në vërtetimin e përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Ata sigurojnë një burim të qartë informacioni për shërbimin që Operatori do të ofrojë dhe garantojnë që të dhënat teknike të paisjeve përputhen me specifikimet e nevojshme. Meqenëse çdo prodhues ka mënyrën e vet të organizimit dhe strukturimit të katalogut ose dokumentave teknike, është e rëndësishme që këto dokumente të përmbajnë emërtimet e saktë të paisjeve dhe specifikimet teknike. Kjo ndihmon në evitimin e keqkuptimeve dhe siguron që mallrat përputhen me specifikimet në mënyrë të qartë dhe efikase.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testeve zyrtare /deklaratë nga prodhuesi mbi testimet që kryhen për mallrat si më poshtë:

-Çelesat 245 kV

-Sistemin e monitorimit të çelesave

-Panelet e KKL

Argumentimi: Ky kriter është vendosur referuar nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar testimet që do ti bëhen mallrave objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën që vërteton se sistemi i monitorimit të çelesave do të testohet konform standartit IEC/UL-61010-1 ose ekvivalent.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur referuar nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar standartet e testimit të sistemit të monitorimit të çelesave.

Standarti IEC 61010-1 përcakton kërkesat për sigurinë e pajisjeve matëse, monitorimit dhe përdorimeve laboratorike. Sistemi i monitorimit të çelesave 245 kV përbëhet nga pajisje matëse dhe monitoruese. Këto pajisje instalohen pranë çelësave në Nënstacionin e HEC Fierze dhe do të operojnë në prani të fushave elektromagnetike të fuqishme, për shkak të prezencës së fushës elektrike të nivelit 220 kV. Interferencat që lindin nga këto fusha magnetike mund të shkaktojnë probleme serioze në funksionalitetin e pajisjeve monitoruese. Për këtë arsye, është e domosdoshme të merren masa për të zvogëluar këtë ndikim negativ. Standardi i përmendur më lart përcakton të gjitha masat që duhet të merren dhe rekomandon testet që duhet të kryhen për të verifikuar mbrojtjen nga interferencat elektro-magnetike. Operatori ekonomik (OE) duhet të dëshmojë se pajisjet do të nenshtrohen testeve në përputhje me këtë standard, për të siguruar (AK) se këto pajisje do të jenë funksionale dhe nuk do të hasin probleme gjatë punës në mjedisin me ndikim të fushave elektromagnetike.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”
- ISO 50001-2018 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 50001-2018 “Sistemi i menaxhimit të energjisë” – Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Sipas standarteve dhe rekomandimeve të prodhueseve paisjet në tension të lartë, duhet te plotesojne te gjitha kriteret per te patur qendrueshmeri per kohe te gjate ne nivel tensioni 220kV. Te gjithë parametrat e celesave jane kerkuar per te garantuar siguri ne operim, duke marre parasysh nivelin e tensionit, dhe frekuencen e madhe te komutimeve qe ndodh ne keto nenstacione per shkak te leshimit dhe ndalimit te agregateve sipas regjimit (edhe disa here ne dite). Teknologjia e operimit të çelësave ekzistues është me mekanizëm me presion vaji dhe vitet e fundit janë konstatuar problematika te shumta ku ka dështuar funksionimi i mekanizimit për shkak të rrjedhjeve të vajit dhe probleme të tjera mekanike të pompës së karikimit të presionit dhe duhet qe te rimbushet me vaj periodikidht.

Sa më sipër në specifikime teknike jane kerkuar çelësa me suste, pasi jane me te qëndrueshme dhe më të lehta per sa i perket mirembajtjes.

Gjithashtu në këto çelësa është e nevojshme që të kryhen rimbushje me gaz SF₆, në mënyrë periodike që do të thotë që ka rrjedhje të konsiderueshme edhe të gazit. Duke marrë shkas edhe nga impakti negativ që gazi SF₆ jep në natyrë, ku 1kg SF₆ ka impakt negativ për efektin serë, 23 500 herë më shumë se sa një kg CO₂, lind e nevojshme që së bashku me çelësat duhet të instalohen edhe sisteme monitorimi për rrjedhjen e gazit SF₆, po ashtu dhe parametrave të tjerë.

Sistemet e monitorimit janë kërkuar që të plotesojnë të gjitha kriteret e percaktuara nga standartet për operim të sigurtë nën ndikimin e fushave elektromagnetike. Të gjitha parametrat që janë kërkuar që të monitorohen, shërbejnë dhe janë të nevojshme për të krijuar një panoramë shumë të qartë të gjendjes teknike të celesave. Të gjitha kërkesat për ndërfaqe dhe komunikim janë për të krijuar lehtësi në aksesin e të dhënave dhe në arshivimin e tyre, për të patur një historik të ndryshimit të parametrave.

Panelet ndërmjetëse KKL shërbejnë si pikë nyje për grumbullimin e të gjithë qarqeve sekondare të elementeve të trakteve të nënstacionit. Gadishmeria e këtyre paneleve është siguruar me shërbime remonti dhe kontrole të vazhdueshme duke i mirembajtur me elemente të marra në magazine dhe me riparime të vazhdueshme. Gjendja teknike dhe gatishmeria e këtyre paneleve efektin direkt funksionimin normal të punës jo vetëm të pajisjeve të lidhura në to por edhe të agregateve në përgjithësi. Sa më sipër në specifikime është kërkuar që të realizohet shkalla më e lartë e hermeticitetit. Gjithashtu që të vertetohet IP65, duhet të deshmohet testimi në laboratore të akredituar. Permasat e panelit janë kërkuar në mënyrë të tillë që të montohen të gjithë elementet e nevojshëm me hapsirat e nevojshme për të lejuar kalimin e kabllave lehtësisht.

Njësia e Prokurimit